



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

VENDIM

Nr. 19, datë 12.05.2015

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË U
ELBASAN FSHAT SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe vendimit të KKRR nr.22 datë 14.11.2014 "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2015", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë U Elbasan Fshat Sha:

a. Tarifë volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë:

Konsumator familjar	38 lek/m ³
Institucione buxhetore	120 lek/m ³
Ente private	120 lek/m ³
Shitje uji me shumice për:	
* Komunën Gostime	30 lek/m ³
* Komunën Qerret	10 lek/m ³

b. Tarifë fikse

Konsumator familjar	120 lek/muaj/klient
Institucione buxhetore	120 lek/muaj/klient
Ente private	120 lek/muaj/klient

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2015:

➤ uji pa të ardhura (humbjet)	29 %
➤ niveli i matjes	70 %
➤ kohëzgjatja e furnizimi	16 orë/ditë
➤ eficaenca e energjisë	2.31 kwh/m ³
➤ efikasiteti i stafit	13 p/000/lidhje
➤ mbulimi me ujë	60%
➤ norma e arkëtimit	97 %
➤ cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standarteve

3. Pagesa rregullatore vjetore për U Elbasan Fshat Sha do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.
4. Vendimi KKRR nr. 44 datë 23.12.2011 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha U Elbasan Fshat” shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi më 01.06.2015 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi